

STATISTIKAT E BUJQËSISË

2025

Në vitin 2025, prodhimi bujqësor në vend, shënoi vlerën 9.731.031 tonë.

- Drithërat arritën në 623.957 tonë, me nivelin më të lartë të prodhimit në Qarkun Fier me 144.404 tonë, ndjekur nga Elbasani dhe Korça.
- Perimet regjistruan një prodhim prej 1.445.286 tonë, me rritje 1,5 %, krahasuar me një vit më parë. Fieri, Tirana dhe Berati janë qarqet me prodhimin më të lartë me rreth 62 %.
- Prodhimi i grurit shënoi rënie me 10,1 %, ndërsa elbi shënoi rritje me 13,6 %, duke arritur në 27.027 tonë.
- Bimët medicinale shënuan rritje përkatësisht me 9,6 %, ndërsa prodhimi i patates ka pësuar rënie me 7,2 %.

Prodhimi në serra

- Prodhimi në serra përfaqëson 22,1 % të perimeve gjithsej, por me një rënie nga viti i kaluar prej 0,9 %.
- Qarku Fier (me 155.905 ton), kontribuon me 48,7 % dhe Berati (me 97.648 ton) me 30,5 % të këtij prodhimi. Qarqet Dibër dhe Lezhë paraqesin një tendencë në rritje krahasimisht me vitin e kaluar, me respektivisht 16,3 % dhe 5,1 %.

Struktura e perimeve

- Perimet e njoma përbëjnë 65,8 % të prodhimit total, duke shënuar një rritje prej 1,07 %, krahasuar me vitin e kaluar.
- Perimet e thata kanë pësuar rënie, krahasuar me vitin 2024, me 6,7 % të prodhimit të kësaj kategorie.
- Kategoria e bostanoreve, për vitin 2025 arriti prodhimin prej 366.675 tonë, duke shënuar rritje prej 5,7 %, krahasuar me vitin 2024.

Drufitorët

- Prodhimi i pemëve frutore ishte 253.450 në vitin 2025, duke pësuar rënie prej 12,8 %. Nivelin më të lartë të prodhimit e vërejmë në Qarkun Korçë si kontribuesin kryesor (66.178 tonë), pasuar nga Elbasani dhe Fieri.
- Në grupin e pemëve farore, molla zë peshën kryesore me 81,8 % të prodhimit, ndërsa në grupin e pemëve me bërthamë, kumbulla dominon me 41,0 % të prodhimit.
- Prodhimi i ullinjve gjatë vitit 2025 arriti në 143.383 tonë me një ulje prej 2,3 %, krahasuar me vitin 2024. Qarqet Fier, Elbasan, Berat dhe Vlorë përfaqësojnë 83,2 % të prodhimit total të ullinjve në vend, duke mbetur zonat kryesore të kultivimit të ullirit në Shqipëri.
- Prodhimi gjithsej i agrumeve në vend është 59.417 tonë, me Qarkun Vlorë kontribues kryesor në me 60,9 %, të prodhimit gjithsej në vend.

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Bujqësia](#)

Metodologjia

Statistikat e bujqësisë për vitin 2025 mbështeten në të dhënat administrative të mbledhura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore është Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe Ligji nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026”. Gjithashtu, në hartimin e këtyre statistikave zbatohen klasifikimet dhe përkufizimet e përcaktuara në rregulloret përkatëse evropiane, përfshirë Rregulloren (KE) nr. 543/2009 mbi statistikat e bujqësisë.

Informacioni mblidhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim i prodhimit të vjelë dhe përfshin sasi të shitura, ato të konsumuara drejtpërdrejt nga familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit.

Statistikat e bimëve u referohen të dhënave vjetore, si: sipërfaqja e kultivuar, sipërfaqja prodhuese për drufrutorët, prodhimi dhe rendimenti.

Përkufizime

Viti i prodhimit

Me vit prodhimi nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

Klasifikimi

Klasifikimi i bimëve të arave bëhet sipas grupeve të kulturave (drithëra, perime, bimë industriale, bimë foragjere, bimë vajore, patate dhe fasule), në fushë të hapur dhe në sera, si kulturë e parë dhe kulturë e dytë. Klasifikimi i drufrutorëve bëhet sipas grupeve kryesore: pemë frutore, ullinj, agrume, vreshta dhe pjergulla, duke përfshirë numrin e përgjithshëm të pemëve, numrin e pemëve në prodhim, prodhimin dhe rendimentin.

Sipërfaqja e kultivuar

Sipërfaqja e kultivuar korrespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore specifike gjatë një viti kalendarik të dhënë. Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e mbjella me kultura të para dhe të dyta. Sipërfaqja e perimeve gjithsej përfaqësohet nga sipërfaqja e perimeve të njoma, të thata dhe bostanoreve. Nga kjo sipërfaqe përjashtohen sipërfaqet e dëmtuara nga fatkeqësi natyrore (përmbytje, zjarre etj.).

Serrë

Serrë është ambienti i mbuluar me xham ose me mbulesë të lartë (që lejon kalimin e personave ose të mjeteve mekanike), të fiksuar ose të lëvizshëm (prej xhami ose plastike të fortë apo fleksibël), ku bimët kultivohen gjatë gjithë periudhës së rritjes ose gjatë pjesës më të madhe të saj.

Pemët frutore

Pemët frutore përfaqësohen nga frutat farore (mollë, dardhë, ftua), frutat bërthamore (kumbulla, qershia, pjeshka, kajsia), frutat subtropikale (fiq, hurma, shega), frutat arnore (arra, gështenja, bajame dhe lajthi), si dhe fruta të tjera.

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja potenciale prodhuese. Përfshihen sipërfaqet e pemëtoreve të reja, blloqet e drufrutorëve extensive dhe të degraduara.